

**SHKOLLAT E MESME ARTISTIKE, SPORTIVE, GJUHËVE TË  
HUAJA, ME KOHË TË SHKURTUAR**

**PJESA I**

**EPOSI I KRESHNIKËVE - “Martesa e Halilit” (fragment)**

Lum për ty, o i lumi Zot,  
fort po shndrit nj’aj djell e pak po  
nxeh!.

Ç’po e merr fryma rrapin e  
Jutbinës!

borë e madhe paska ra,  
randojnë ahët për me u thye,  
kishin çetinat vetëm kreshtat;  
ushtojnë lugjet prej orteqesh,  
prej orteqesh kah po bijnë ndër  
gropa.

Kanë ra vashat me gja në lumë,  
Kanë nisë vashat me lypë krojet

kanë gjetë krojet tanë ngri hej.  
Kanë gjetë lumin ngri akull;

-----

At be n’Zotin djali paska ba:  
“Dheu m’ka mblue e fat s’i qita  
vedit

....

Fjalor:

**Jutbinë:** qendra e Krahinës

**Krahinë:** krahinë ku zhvillohen ngjarjet në Eposin tonë

**çetinë:** pishë

**hej -e:** shufra akulli

po s’e mora Tanushën e Krajlit  
Po n’qafë m’paçi, mori Bjeshkët e  
Nalta,

Kurrkund një shteg që nuk ma latë  
Për me dalë deri në Krajli!”

Sa mirë nama bjeshkët m’i paska  
gjue,

sa shpejt deti djalin ka ndigjue!

E e ka çue një frymë të fortë,

e e ka çue një frymë të nxehtë,

e e ka lshue krejt renë e zezë.

Bijnë orteqet nëpër gropa,

ushtojnë malet si prej motit.

Por tri ditë e ma s’ka zgjatë,

a shkri bora e ka ra n’lumë;

por tri javë e ma s’ka zgjatë,

Ç’ka e ka ba lumi ata t’bardhë?

T’bardhët e bjeshkve krejt e ka

mbytë n’det...

*Matura Shtetërore 2007, Teste*

---

*Për pyetjet 1-5 rretho vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.*

- 12.** Cikli i kreshnikëve bën pjesë në: **1 pikë**  
A) lirikën popullore  
B) epikën historike  
C) epikën legjendare  
D) kanunin e Lekë Dukagjinit
- 13.** Vargu i ciklit të kreshnikëve është: **1 pikë**  
A) 8-rrokësh  
B) 9-rrokësh  
C) 10- rrokësh  
D) 12-rrokësh
- 14.** Konflikti qendror në këtë cikël është: **1 pikë**  
A) greko-shqiptar  
B) romako-ilir  
C) sllavo-shqiptar  
D) turko-shqiptar
- 15.** Cila është figura letrare e përdorur më shumë në të? **1 pikë**  
A) Metafora  
B) Hiperbola  
C) Metonimia  
D) Simboli
- 16.** Pika kulminante e këngës “Martesa e Halilit” është kur: **1 pikë**  
A) Halili i bie lahutës përpara ekzekutimit.  
B) Halilin e veshur si grua e zbulojnë.  
C) Halili takohet me Tanushën.  
D) Halili arrin në kullën e Tanushës.
- 17.** Si shfaqen përmes vargjeve disa veçori zakonore të jetesës së kreshnikëve? Përmend të paktën dy veçori. **2 pikë**
- 18.** Trego ku qëndron trajta paradoksale në vargun: *fort po shndrit nj’aj djell e pak po nxeh!* Ç’efekt krijon ajo te lexuesi? **2 pikë**

*Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I*

---

19. Në përshkrimin e natyrës në një ditë të ftohtë dimri, gjej mjetet e stilistikës (të paktën dy) që japin konceptin hiperbolik të kësaj tabloje dhe shpjegoji ato. Në ç'raport është natyra me kreshnikët dhe bëmat e tyre? **5 pikë**
20. Gjej në fragment një pyetje retorike dhe shpjego funksionin e saj stilistik. Trego pse pyetja retorike përdoret shpesh në Eposin tonë (“Ç’a kish bari trimi Gjergj Alia?”). **2 pikë**
21. Gjej në vargjet ku përshkruhet ardhja e pranverës (*Sa mirë bjeshka...N’det*) detajet që e bëjnë atë reale dhe njëherazi fantastike. Shkrija e reales me fantastiken bëhet me qëllim nga rapsodi. Pse? Cili është mjeti bazë i stilistikës që përftohet nga shkrija e tyre. Argumentoje mendimin tënd edhe me ilustrime nga fragmenti. **4 pikë**